



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE

Nr. 117/3 Prot.

Tiranë më 7.02.2019

REKOMANDIM

Nr. 04, datë 7.02.2019

PËR KONTROLLUESIN “AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE”

Në mbështetje të neneve 29, 30, 31 pika 1 gërma a/1, dhe 32 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit “Autoriteti i Mediave Audiovizive”,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 20 datë 23.01.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit “Autoriteti i Mediave Audiovizive”, me objekt:

- Zbatimi i nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Autoriteti i Mediave Audiovizive është institucion qendror publik, i pavarur i cili kontrollon zbatimin e ligjit për mediat nga subjektet që ushtrojnë veprimtari në fushën audiovizive.

Nga verifikimi i kryer në vend, rezultoi se:

1. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë në portalin <http://www.ama.gov.al>, me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal, por ka publikuar një informacion të shkurtër mbi ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave. Informacioni i publikuar në rubrikën “Politikat e Privatësisë”, duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit, pika 1: *Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale...*” dhe Vendimit nr. 6/2013 *“Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale”*.

2. Konstatohet se kontrolluesi nuk informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave *“nëpunës”, “vizitorë”, etj.*, mbi prezencën e sistemit të video-survejjimit (CCTV), sipas Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*. Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

Konstatimi sa i përket informimit jo të plotë të subjekteve të të dhënave, mbi qëllimin e përpunimit të të dhënave, ushtrimit të të drejtave, të drejtën e ankimit etj., gjatë përpunimit të të dhënave personale imazhe-video nëpërmjet sistemit të video-survejjimit (CCTV) nga kontrolluesi, përbën shkelje administrative të nenit 18 të ligjit dhe Udhëzimit Nr.3/2010 të Komisionerit *“Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejjimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”*.

3. Kontrolluesi ka përfshirë në formularët e kërkesave dhe ankesave, dispozita mbi detyrimin për zbatimin e ligjit nr.9887/2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar, dhe të drejtën e ankimit pranë Zyrës së Komisionerit.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i kontrollit hartoi dhe nënshkroi në prani të palëve procesverbalin e hetimit administrativ. Lidhur me konstatimet e grupit të hetimit administrativ, përfaqësuesit e kontrolluesit nuk patën kundërshtime, por kërkuan kohë për plotësimin e detyrimeve ligjore.

Sa më sipër, në zbatim të neneve 18, 29, 30, 31 dhe 32 pika 1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”* i ndryshuar,

#### **REKOMANDOJ:**

1. Kontrolluesi *“Autoriteti i Mediave Audiovizive”* në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”*, i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale, qëllimin e përpunimit, mjetet dhe mënyrat e përpunimit, përhapjen e të dhënave etj., nëpërmjet *“Politikës së Privatësisë”* në portalin zyrtar <http://www.ama.gov.al>.
2. Kontrolluesi *“Autoriteti i Mediave Audiovizive”* në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887/2008 *“Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”* i ndryshuar, të informojë subjektet e të dhënave personale mbi praninë e sistemit të video vëzhgimit nëpërmjet tabelave informuese, sipas modelit standard të miratuar nga Zyra e

Komisionerit, me Udhëzimin nr. 3/2010 të Komisionerit “Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera”.

3. Kontrolluesi “Autoriteti i Mediave Audiovizive”, të kryejë të gjitha detyrimet që burojnë nga ligji dhe nga ky akt, brenda një afati 10 ditor nga momenti i marrjes dijeni dhe të njoftojë me shkrim Zyrën e Komisionerit për masat e marra. Përbushja e këtyre detyrimeve nga kontrolluesi, përbën objekt kontrolli të vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit.
4. Në rast mos përbushje të detyrimeve të caktuara, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të Rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 7.02.2019.

**KOMISIONERI**

**Besnik Dervishi**

